

	POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT	PO-SIM-002
	ver. 2.0	<small>OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C OPERATOR SISTEMA PËRËNOSA I TRZISTA KOSTT d.d</small>
Menaxhimi Cilësisë dhe Politikave		Nr. <u>1559</u> Dt. <u>14.08.2023</u> PRISHTINË-A

POLITIKA E SIGURISË SË INFORMACIONIT

KOSTT sh.a, është Operator i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës, një subjekt i cili luan rol të rëndësishëm në sektorin e energjisë në Kosovë.

Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit të KOSTT ka për qëllim të siguroj:

- A. Informatat në KOSTT në të gjitha format: të shkruar, verbale, të ruajtur në mënyrë elektronike ose të shtypur, do të mbrohen nga modifikimi aksidental ose i qëllimshëm i paautorizuar, shkatërrimi ose zbulimi gjatë gjithë ciklit të tij të jetës. Kjo mbrojtje përfshin një nivel të duhur sigurie mbi pajisjet dhe softverët e përdorur për përpunimin, ruajtjen dhe transmetimin e informacionit.
- B. Të gjitha Politikat, Procedurat, Udhëzimet dhe Dokumentet tjera të dokumentuara në versionin final dhe të aprovuara, duhet të vihen në dispozicion për të gjithë personat përgjegjës për të siguruar konformitetet dhe pajtueshmëri. Të gjitha aktivitetet e identifikuar në kompani, duhet gjithashtu të dokumentohen. I tërë dokumentacioni, i cili mund të jetë në formë elektronike, duhet të ruhet të paktën 6 (gjashtë) vite pas krijimit fillestar, ose, nëse janë të ndërlidhura me Politikën dhe Procedurat, pas ndryshimit të tyre. I tërë dokumentacioni duhet të rishikohet për përshtatshmëri në mënyrë periodike më së largu një herë në vit.
- C. Të gjitha dokumentet që do të krijohen në të gjitha Departamentet dhe njësitë tjera të KOSTT, do të përgatiten në përputhshmëri me këtë politikë, standardet e zbatuara dhe orientimin strategjik të kompanisë. Të gjitha dokumentet në nivel të Departamenteve duhet të jenë në përputhje me këtë politikë. Të gjitha sistemet e zbatuara pas datës së aprovimit të kësaj Politike pritet të jenë në përputhje me orientimin strategjik dhe dispozitat e kësaj politike.

II. FUSHËVEPRIMI

- A. Fushëveprimi i sigurisë së informacionit përfshin mbrojtjen e konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit të ruajtur dhe të procesuar nga KOSTT.
- B. Ekipi kompetent i autorizuar për menaxhim të sigurisë së informacionit, siguron integritetin e të gjitha dokumenteve të aprovuara në KOSTT dhe mbrojtjen e CIA-s së të gjitha të dhënave tjera të përpunuara dhe të ruajtura në pajisjet e KOSTT.
- C. Përmes Politikës së sigurisë së informacionit, KOSTT demonstroi përkushtimin ndaj menaxhimit efektiv të gjitha informatave të brendshme dhe të jashtme në kategoritë e përcaktuara në matricën e klasifikimit të informacionit të KOSTT.

Datë: 14.08.2023

Kryeshef Ekzekutiv
Evetar Zeqiri

